



**Emri i biznesit:** "Kumanova Cable" Sh.p.k  
**Nr. i biznesit:** 71085139  
**Pronar:** Bashkim LUMI  
**Operatori i Shpërndarjes:** "Kumanova Cable Sh.p.k."  
**Platforma:** Kabllore  
**Adresa:** Therandë



### VENDIM

për ripërtitjen e licencës së KPM-së për Operatorin e Shpërndarjes Kumanova Cable  
SH.P.K. Platforma Kabllore, me seli në Therandë

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Kumanova Cable SH.P.K. është operatorë i shpërndarjes, i cili ishte licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audivizuale përmes sistemit kabllorë, me seli në Therandë. KPM, me datën 27 shtator 2010, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorin e shpërndarjes Kumanova Cable SH.P.K., për një afat të licencës prej dhjetë (10) vitesh.
3. Me datën 27 shtator 2020, ka skaduar afati i licencës së operatorit të shpërndarjes Kumanova Cable SH.P.K. –Platforma Kabllore, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidatit i ofrohet e drejta të kërkojë ripërtitjen e licencës në afat brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 8 tetor 2020, operatori i shpërndarjes Kumanova Cable SH.P.K. ka parashtruar kërkesën në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka shprehur interesimin për ripërtitje të Licencës së KPM-së.

### Arsyetimi

5. Operatori i Shpërndarjes Kumanova Cable SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për ripërtitje të licencës së KPM-së duke shfrytëzuar të drejtën e ripërtitjes së licencës e paraparë me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në.

6. Neni 25 i Ligjit për KPM-në, i cili thekson:

*“Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritet për shkak të shkëlqes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audiovizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës”,*

krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje në pajtim me ligjin për KPM.

**Vendim**

7. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 13 nëntor 2020, në pajtim me Nenin 25 të Ligjit për KPM-në, merr vendim për ripërtëritjen e licencës së Operatorit të Shpërndarjes Kumanova Cable SH.P.K.- Platforma Kabllore, për të ushtruar veprimtarin e shpërndarjes së shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale në Republikën e Kosovës.
8. Licenca e KPM-së për operatorin e shpërndarjes Kumanova Cable SH.P.K. do të jetë e vlefshme në afat prej 10 (dhjetë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 27 shtator 2020.
9. Të gjitha parametrat e Licencës së KPM-së, shtrirja e rrjetit të operatorit të shpërndarjes Kumanova Cable SH.P.K., si dhe lista e kanaleve sipas katalogut që është pjesë përbërëse e Licencës së KPM-së, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
10. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

  
Xhevat LATIFI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



13.11.2020  
datë